VENDIM
Nr.359, datë 12.5.2010

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË PJESËMARRJES SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN KOMUNITAR "KULTURA 2007-2013"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin, në parim, të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin komunitar "Kultura 2007-2013", për periudhën 2011-2013.

2.Kostoja e pjesëmarrjes në këtë program, për secilin vit, do të mbulohet, në masën 90 për qind, nga fondet e programit të Instrumentit të Paraaderimit (IPA) të alokuara nga Bashkimi Europian, për Shqipërinë, dhe në masën 10 për qind nga buxheti i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3.Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Integrimit Europian për zbatimin e këtij programi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Çështjet që theksohen për diskutim janë si më poshtë:

-Taksa e hyrjes - Shuma që Shqipëria duhet të paguajë për të marrë pjesë në këtë program është 41 000 euro/vit. Kjo shumë do të bashkëfinancohet në formulën 90 për qind nga fondet IPA dhe 10 për qind nga Buxheti i Shtetit (buxheti i MTKRS-së).

- Komisioni i BE-së kërkon që kjo formulë të ndryshojë duke treguar një rritje në financimin nga Buxheti i Shtetit, për të treguar një angazhim nga pala shqiptare.

Termat e financimit mund të jenë si më poshtë:

Viti	2011	2012	2013
Fondet komunitare	IPA 2009	IPA 2009	IPA 2010
Fondet komunitare	36 000 euro	35 000 euro	34 000 euro
Buxheti MTKRS	5000 euro	6000 euro	7000 euro

Shënim. Shuma prej 41 000 euro duhet të paguhet nga MTKRS në muajt e parë të vitit 2011 dhe më vonë rimbursohet nga delegacioni i BE-së në Tiranë.